



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SHK. II.nr. 1659/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbarimore të kreditorit “Nera Apetrol” SH.P.K., me NUI: 81140001, me seli në Lipjan, kundër debitorit “BM Group” SH.P.K., me NUI: 810839251, me seli në rr. “Shkupi BLL.E5, OB.A, Linda Premium Residence L9”, p.n., duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.549/23 të datës 12.09.2023, me datë 29.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e Debitorit “BM Group” SH.P.K., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 549/23 të datës 12.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar 549/23 të datës 12.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “BM Group” SH.P.K., me numër unik identifikues 810839251, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbarimor P.nr. 77/23, i lejuar me datë 02.03.2023, nga Përmbaruesi Privat Besnik Aliu, për pjesën e detyrimit në shumën prej EUR 12,480.00 (dymbëdhjetëmijë e katërqind e tetëdhjetë euro) Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit “BM Group” SH.P.K., me numër unik identifikues 810839251, për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 71,955.00 € (shtatëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë euro), dhe ka lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor P.nr. 77/23, i lejuar me datë 02.03.2023, nga Përmbaruesi Privat Besnik Aliu, së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej

8%, po ashtu në pikën III ka Përfunduar pjesërisht procedura përmbare e kreditorit “Nera Apetrol” SH.P.K., ndaj debitorit “BM Group” SH.P.K., sipas Urdhrit Përmbare P.nr.77/23 të datës 02.03.2023, për shumën prej 12,480.00 € (dymbëdhjetëmijë e katërqind e tetëdhjetë euro),

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1659/23 të datës 12.09.2023.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se debitori është qartazi i pa bazuar dhe i pambështetur me prova dhe me fakte dhe ankesa e parashtruara nga ana e tij ka për qëllim vetëm prolongimin e procedurës përmbare . Andaj ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë, që të refuzoj në tërësi ankesën e debitorit dhe të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1659/23 të datës 12.09.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Nera Apetrol” SH.P.K. të dt. 28.01.2022, ka paraqitur propozim për përmbare mbi bazën e dokumenteve të besueshme - Faturës Nr. 190422-002 të datës 19.04.2022; Faturës Nr. 150722-001 të datës 15.07.2022; Faturës Nr. 12/21080422-003 të datës 08.04.2022; Faturës Nr. 120422-002 të datës 12.04.2022 dhe Faturës Nr. 020422-002 të datës 02.04.2022; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 84,435.00 €, me kamatë prej 8%, duke filluar nga arritshmëria e kërkesës për pagesë e deri në pagesën definitive të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës përmbare, ashtu që përmbaresi borxhin ta inkasoi me bllokimin e llogarive bankare të debitorit, si dhe me regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Përmbareuesi Privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr. 77/23, të datës 02.03.2023, e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar se të gjitha obligimet ligjore janë kryer sipas marrëveshjes të cilat i ka pasur debitori dhe se borxhi i mbetur nuk është ky të cilin e paraqet kreditori. Ka theksuar se Fatura Nr. 190422-002 e datës 19.04.2022 është paguar në tërësi, duke i bashkëngjitur edhe pagesën e kësaj fature si dëshmi. Ka shtuar se për shkak të bashkëpunimit ndër vite që debitori ka pasur me kreditorin, është e pa pranueshme dërgimi i lëndës tek përmbareuesi privat pa u barazuar kartelat financiare. Në fund ka theksuar që do të vazhdojnë me shlyerjen e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga barazimi në momentin e korrigjimit dhe barazimit të kartelave. Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit si të pa bazuara, duke theksuar që faturat në bazë të cilës është lejuar përmbarimi i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore. Më tutje ka shtuar se në lidhje me Faturën Nr. 190422-002 të datës 19.04.2022 në shumën prej 12,480.00 €, kreditori e tërheq kërkesën ngase kjo faturë është paguar. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar dhe ta vërtetoj urdhrin për përmbarim të lejuar nga përmbareuesi privat.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit, Dhoma e shkallës së parë pas shqyrtimit të shkresave dhe analizim të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.77/23 i datës 02.03.2023 duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr. 190422-002 të datës 19.04.2022, pasi që në bazë të provave që gjenden në shkresa të lëndës, përkatësisht në bazë të Urdhërpagesës të datës 19.04.2022, si dhe pohimit të kreditorit të cekur në përgjigjen në prapësim, vërtetohet fakti se debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin e tij. Andaj, duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: “dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbareues ose urdhri përmbareues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik” aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm - fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta është përmbushur nga ana e debitorit

Ndërsa, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.77/23 të datës 02.03.2023 për shumën në vlerë prej 71,955.00 €, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbnim me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbnim për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se Urdhri Përmbnimor P.nr. 77/23, i lejuar me datë 02.03.2023, gjeti se Faturen Nr. 150722-001 të datës 15.07.2022; Faturën Nr. 12/21080422-003 të datës 08.04.2022; Faturën Nr. 120422-002 të datës 12.04.2022 dhe Faturën Nr. 020422-002 të datës 02.04.2022, të cilat fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbnim, përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Mbi këtë bazë Gjykata vlerëson se dokumenti mbi bazën e të cilit është mbështetur propozimi për përmbnim, dhe është lejuar përmbnim paraqet bazë për lejimin e përmbnimit dhe e njëjta ka tipare të përmbnueshmërisë. Po ashtu gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim se të gjitha obligimet ligjore janë kryer sipas marrëveshjes të cilat i ka pasur debitori dhe se borxhi i mbetur nuk është ky të cilin e paraqet kreditori, duke theksuar se Fatura Nr. 190422-002 e datës 19.04.2022 në shumën prej 12,480.00 €, është paguar në tërësi, duke i bashkëngjitur edhe pagesën e kësaj fature si dëshmi, po ashtu edhe kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se Fatura me Nr. 190422-002 të datës 19.04.2022 në shumën prej 12,480.00 €, e tërheqi sepse e njëjta është paguar, andaj Gjykata gjeti se urdhri për lejimin e përmbnimit për

këtë pjesë të përbarimit duhet përfunduar, dhe u vendos si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, duke përfunduar urdhri për lejimin e përbarimit në vlerë prej 12,480.00 €.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit meqenëse debitori një pjesë të detyrimit ndaj kreditorit e ka përmbushur duke paguar faturën me numër 190422-002 të datës 19.04.2022 në vlerë prej 12,480.00 €, andaj edhe përfundohet urdhri përbarimor për pjesën e borxhit prej 12,480.00 €, ndërsa Dhoma e shkallës së dytë, sa i përket pikës II të dispozitivit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit ndërsa ka lejuar urdhrin përbarimor në shumën prej 71,955.00 €, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përbarim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, e që në rastin konkret faturat në fjalë i ka pranuar debitori.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit duke theksuar se ka bërë një pjesë të pagesës së faturës me Nr.150722-001 e datës 15.07.2022 për shumën 16.950.00euro, por një pretendim të tillë e refuzoi si të pa bazuar sepse provën gjegjësisht dëshmin për pagesë që ja ka bashkangjitur debitori në ankesë rezulton se nuk është në origjinal ngase nuk përmbanë vulën e bankës apo vulën digjitale të bankës e për më tepër nuk figurojnë që pagesa është aprovuar në mënyrë elektronike në mënyrë që të vërtetohet se kjo urdhërpagesë është lëshuar vërtet nga TEB-Banka apo është aprovuar një pagesë e tillë.

Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarrimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarrimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1659/23 me datë 29.05.2024

Gjyqtari,
Franciska Zhitija Ymeri